

VENDIM
Nr. 111, datë 6.2.2015

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 634, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE
DHËNIEN ME KONCESION /PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE
PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE, PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, shkronja “j”, dhe 2, e 49, të ligjit 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, të miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas nenit 28 shtohet neni 28/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 28/1

Përmbushja e kriterëve të parakualifikimit nëpërmjet një bashkëpunëtori

1. Ofertuesi (ose nëse ofertuesi është një konsorcium apo anëtar konsorciumi) mund të zgjedhë të paraqesë prova (përfshirë pasqyrat financiare) nga një bashkëpunëtor, me qëllim përmbushjen e kushteve financiare.

2. Ofertuesi (ose nëse ofertuesi është një konsorcium apo anëtar konsorciumi) mund të zgjedhë të paraqesë provat e punimeve dhe shërbimeve nga një bashkëpunëtor, me qëllim përmbushjen e kriterëve teknike.

3. Për qëllimet e këtij dokumenti parakualifikimi, “Bashkëpunëtor”, nënkupton çdo subjekt që e kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kontrollohet nga/ose është nën kontroll të përbashkët me ofertuesin; “kontroll”, është pushteti për të zgjedhur shumicën e bordit të drejtorëve (ose organe përbërëse të ngjashme) ose autoriteti për të drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë menaxhimin dhe politikën e një enti, nëpërmjet zotërimit të shumicës së letrave me vlerë, me kontratë, ndërsa “duke kontrolluar” dhe “i kontrolluar” kanë kuptime të lidhura reciprokisht.

4. Nëse ndonjë kriter kualifikimi, teknik apo financiar, është zbatuar nga ana e ndonjë subjekti që është bashkëpunëtor i ofertuesit, ofertuesi, në këtë rast, duhet të paraqesë dokumente që vërtetojnë se një subjekt i tillë përmbush kushtet e bashkëpunëtorit, siç edhe është parashikuar më lart.

5. Për qëllimet e mësipërme, bashkëpunëtori, duhet të paraqesë një letër ku të marrë përsipër se do të vërë në dispozicion të ofertuesit të gjitha burimet e nevojshme.”

6. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama